

JORGJI GJINARI

NDËRRIME TINGUJSH NË GJUHËN LETRARE SHQIPE *)

Në këtë artikull do të trajtojmë ato ndërrime (alternime) fonetike që janë veçori e gjuhës së sotme letrare, ato që bëjnë një normë të përbashkët letrare, qofshin me një trajtë të vetme ose me variante. Përsa u përket llojeve të stileve që lidhen me ritmin e të folurit, do të trajtojmë ato ndërrime fonetike që janë karakteristike vetëm të stilit të plotë dhe jo ato të stilit të shpejtë bisedor.

Një numër i vogël dukurish të këtilla do të mbeten jashtë vështrimit në punimin tonë, sepse, nga njëra anë, në fazën e sotme gjuha jonë letrare ende nuk është kristalizuar plotësisht dhe, nga ana tjetër, mungojnë studime të plota që të përfshinin çdo anë të normës së sotme fonetike të shqipes letrare. Kriteret më të hollësishme, mbi të cilat jemi mbështetur për trajtimin e këtij problemi të gjuhës sonë, ne i kemi shprehur në artikullin tonë të botuar pak më parë¹, megjithëse ato kanë pësuar një farë ndryshimi në punimin e pranishëm.

Sigurisht, këtu do të trajtojmë ndërrimet (alternimet) fonetike, dmth ato ndryshime të tingujve që shkaktojnë ndryshime në përbërjen e fonemave të fjalës, që shkaktojnë ndërrim fonemash.

Duke u mbështetur në kriterin fonetik, dmth në faktin se në ç'masë kushtëzohen fonetikusht ndërrimet e tingujve që ndodhin në fjalë për fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, ato do t'i ndajmë në: 1) *ndërrime mekanike* dhe 2) *ndërrime historike* (tradicionale).

Ndërrimet mekanike

Ndërrimet mekanike ndodhin në kushte të caktuara fonetike nën veprimin e ligjeve të sotme të shqiptimit të gjuhës letrare shqipe. Në kushte të këtilla fonetike ndërrimi i fonemave bëhet patjetër në të gjitha rastet, procesi i kundërt nuk vërehet asnjëherë. Kështu p.sh. *i*-ja, e pa-theksuar që ndodhet në fund të fjalës ndërrohet me *i*-në (variant i fonemës *j*) në çdo rast, pa përjashtim, kur vjen pas një zanoreje të theksuar: *ftoi babai* (babai), *shkoi* (shkoi), *punoi* (punoi) etj.

Ashtu si llojet e tjera të ndërrimeve, edhe këto zbulohen duke krahasuar përbërjen fonetike të së njëjtës morfemë në forma të ndryshme gramatikore të një fjale ose në fjalët e formuara, p.sh. *mali* dhe *ftoi* (ftoi), *foli* dhe *shkoi* (shkoi); *as* dhe *azgjë* (asgjë), *shkarkoj* dhe *zhgënjehem*,

*) Ky artikull përbën variantin e parë të kapitullit përkatës të morfologjisë së tekstit të «Gramatikës shkencore të shqipes».

1) J. Gjinari, *Mendime mbi trajtimin e shndërrimeve fonetike në «Gramatikën e gjuhës së sotme letrare shqipe»*, në Studime filologjike, 3, 1969, f. 207-211.

tok(ë) dhe *togzim* (tokëzim) etj. Përveç këtyre, ka disa raste ku këmbimet e tingujve nuk shkaktohen prej ndërrimit të kushteve fonetike të tingullit gjatë ndryshimit të formave gramatikore e gjatë formimit të fjalëve, p.sh. *absolut* dhe *apsolut*, *ekzistoj* dhe *egzistoj*, *revolucion* dhe *revolucion*, *variant* dhe *variant* etj. Në këto rastet e fundit kemi vetëm një kundërvënje midis shkrimit dhe shqiptimit të fjalëve (shkruajmë *absolut* dhe shqiptojmë *apsolut* për shkak se bashkëtingëllorja e zëshme *b* ndodhet para bashkëtingëllores së shurdhët *s*). Pra, në thelb këtu nuk kemi të bëjmë me ndërrime fonetike. Ky problem nuk do të dilte sot në gjuhën letrare shqipe sikur fjalë të këtilla të shkruheshin ashtu si shqiptohen e jo ashtu si shkruhen e shqiptohen në gjuhë prej të cilave janë marrë. Kështu p.sh. në rastet si: *objektiv*, *rajon*, *Sofje* etj., ku nuk ruhet tradita në shkrim, kjo kundërvënje është kapërcyer.

Ndërrimet mekanike që ndodhin gjatë ndryshimit të formave gramatikore dhe formimit të fjalëve bëjnë të dukshëm dallimin e morfemave por nuk shfrytëzohen si mjete gramatikore, pra ndryshe nga ndërrimet historike.

Në gjuhën e sotme letrare shqipe shumica e rasteve të ndërrimeve mekanike nuk pasqyrohen në shkrim. Kjo shpjegohet me faktin se ndërrime të këtilla janë procese fonetike të kushtëzuara që kryhen nën ndikimin e normave fonetike të sotme të gjuhës sonë.

Ndërrimet mekanike mund të jenë: këmbim i një foneme me një fonemë tjetër: *s'kam* - *z'bëj* (*s'bëj*) dhe rënje ose edhe tretje e një foneme: *emër-emri*, *çaj-çai* (çaji). Disa nga këto ndërrime janë kombinatorë e disa janë pozicionale.

Ndërrime kombinatorë.

Sot në gjuhën letrare shqipe është rregull që bashkëtingëlloret e zhurmëta të shurdhëta të ndërrohen me bashkëtingëllore të zëshme përgjegjëse kur ndodhen para një bashkëtingëllores tjetër të zëshme (veç sonanteve): **s-z**: *azgjë* (asgjë); *mezditë* (mesditë), *Mezdhe* (Mesdhe), *z'gjej* (*s'gjej*), *z'dua* (*s'dua*); **sh-zh**: *zhdëmtoj*, *zhduk*, *zhbllokohet*, *zhgënjej* (krahaso: *shtrydh*, *shpronësoj*, *shkëmbej*); **k-g**: *togzoj* (tokëzoj), *flogbardh* (flokë-bardhë), *kogderr* (kokëderr) etj. **ç-xh**: *xh'do?* ose *zh'do?* (ç'do), *xh'vler kan?* (ç'vlerë kanë?) etj.

E kundërta e këtij procesi ndodh kur një bashkëtingëllore e zëshme pasohet nga një bashkëtingëllore e shurdhët; në këtë rast e zëshmjja ndërrohet me të shurdhëtën përgjegjëse; **b-p**: *elpth* (elbth); **dh-th**: *hithte* (hidhte), *trathti* (tradhëti); **gj-q**: *diqte* (digjte), *përgjeqsi* (përgjegjësi); **g-k**: *lakte* (lagte), *trekti*, (*tregëti*) etj.

Në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe ndërrimet e bashkëtingëllores të shurdhëta në të zëshmet dhe të zëshmeve me të shurdhëtat ndodhin vetëm brenda një fjale, si dhe në një grup prej dy fjalësh kur njëra është e patheksuar dhe tjetra e theksuar. Në kufi të dy fjalëve të theksuara nuk ndodhin këto procese, p.sh. *rreth druri* e jo *rredh druri*, *plep dyvjeçar* ose *deg* (*degë*) *pishe* e jo *dek pishe*, *udh* (*udhë*) *fshati* e jo *uth fshati*.

Sot vërehet se edhe në fjalët e përbëra dhe në fjalët e përngjitura ka një prirje që tingujt fqinjë të mos veprojnë mbi njëri-tjetrin, p.sh. shqiptojmë shpesh: *atdhe*, *kogderr* (kokëderr), *dhjetvjetor* (dhjetëvjetor), *pesdhjet* (pesëdhjetë), *pasdite* etj.

Në raste të këtilla janë akoma të qarta pjesët përbërëse të fjalëve dhe, me sa duket, tema e parë nuk e ka humbur ende plotësisht theksin e vet. Për këtë arsye mund të themi se në këto raste procesi i ndërrimit të fonemave po kufizohet vetëm në gjuhën e stilit të bisedës (në shqiptimin me ritëm të shpejtë).

Zanorja *i* e patheksuar, kur pasohet nga një zanore tjetër e theksuar ose e patheksuar, ndërrohet me bashkëtingëlloren *j* (shpesh shqiptohet *i*, që është një variant i fonemës *j*): *ja dha* (krahaso *i dha*), *atij ju prenë këmbët* (krahaso *i priten këmbët*), *t'ja them* (krahaso *t'i them*), *hapja derën* (krahaso *hapi derën*), *futju kësaj pune* (krahaso *mos i fut dru sobës*) etj.

Vërehet që *i*-ja të mos ndërrohet me *j*-në në fjalë si: *klient*, *austriak*, *industrial*, *patriark* e ndonjë tjetër.

Në këto raste ka arsye fonetike që e shpjegojnë këtë dukuri.

Ndërrimi i zanores *i* të patheksuar me bashkëtingëlloren *j* [i], vërehet edhe në rastet kur *i*-ja vjen pas një zanoreje të theksuar, p.sh.: *vllai* (vëllai) *babai* (babai), *Thomai* (thomai), *ftoi* (ftoi), *kroi* (kroi) *punoj* (punoi), *shkroi* (shkroi), *luftoi* (luftoi) etj. Por sot në stilin e plotë të folurit në këto kushte fonetike shihet si prirje që të mos ndryshojë *i*-ja dhe kjo shpjegohet me faktin se në fazën e sotme të zhvillimit të shqipes së përbashkët nuk është i gjallë ligji sipas të cilit tingulli i parë të ndikojë mbi të dytin kur këta vijnë njëri pas tjetrit, rregullsi kjo që shqipja e ka pasur dikur, por që e ka humbur (psh. *ngarkoj* dhe *mbas* që mendohet të vijnë perspektivisht prej **nkarkoj* (krh. *shkarkoj*), **mpas* (krh. *pas*) etj. të hershme dhe *bankë*, *mpihet* etj. të sotme).

Kur në fjalë ndodhen pranë njëri-tjetrit dy tinguj të njëjtë ose të afërt për nga artikulimi, njëri prej tyre nuk shqiptohet:

a) Tinguj të njëjtë: *tt - t*: *të zotë* (të zottë), *godite* (goditte), *mate matte*, *i argjent(ë)*, (i argjendtë), *i treqinti* (i treqindti), *ente* (endte), *e gjjet(ë) e mira* (e gjettë e mira), *në u mbyt(ë)* (në u mbyttë), *në munt(ë)* (në mundtë) *ss-s*: *pasi* (nga **pas+si*), *mbasi* (nga **mbas+si*). Këto të fundit janë pasqyruar edhe në rregullat e drejtshkrimit të sotëm të shqipes (me *s* e jo *ss*), kurse shumë raste na ato me *tt-t* shkruhen me dy *t*, por ky rregull është vetëm për ato fjalë në të cilat dallohet lehtë sot struktura gramatikore e tyre, sepse për raste të kundërta drejtshkrimit ka pasqyruar shqiptimin me një *t*: *i gjashtë* (< *i gjashtëtë*), *i baltë* (< *i balttë*) etj.

Kur dy bashkëtingëllore të njëjta takohen në një fjalë të përbërë, ato ose shqiptohen të dyja ose shpeshherë shqiptohet e gjatë njëra prej tyre; *flokkuq* ose *flokuq*, *kokkungull* ose *kokungull* (kokëkungull) etj. Arsyeja është se sot janë të dallueshme temat përbërëse të fjalës.

b) Tinguj të afërt nga shqiptimi: *gj + j* — *gj*: *lagjja* — *lagja*, *ndërgjegjja* — *ndërgjegja*, *elegjiak²-elegjak*, *plagjiat(ë)* — *plagjat(ë)*, — *higjiën(ë)* — *higjen(ë)*; *q + j* — *q*: *faqja* — *faqa*, *paqja* — *paqa* etj. Një rregullsi e tillë po vjen duke u kufizuar në stilin e plotë dhe po mbetet karakteristike për stilin e bisedës.

Po për këto arsye, meqenëse janë të afërta në shqiptim edhe në rastet ku bashkëtingëllorja *j* [i-] pasohet nga zanorja *i* e theksuar, *j*-ja

2) Në rastet si: *elegjiak* e të tjera zanorja *i* shqiptohet *j* (i), sepse ndodhet para një zanoreje tjetër të theksuar.

nuk shqiptohet: *jini* (jeni) — *ini*, *flijim* — *fliim*, *pajis* — *pais*, *ujis* — *uis*, *uji-ui*, *vaji-vai*, *maji-mai*, *çaji-çai* etj.

Zanorja ë e patheksuar nuk shqiptohet kur pas saj vjen një zanore tjetër e theksuar ose e patheksuar. Këtu është fjala vetëm për rastet kur shqiptohen njëra pas tjetrës një fjalë e patheksuar me një fjalë të theksuar, p.sh.: *t'egra* (të egra), *t'urta* (të urta), *t'argjenta* (të argjendta) etj. (krahaso: *të mira*, *të forta* etj.); *t'u mbyll*, *t'u thuash*, *t'ua dërgosh* (krahaso: *të mbyll*), *të thuash*, *të dërgosh*; *m'i dha*, *nuk m'u dha* etj. (krahaso: *më dha*). Drejtshkrimi i gjuhës së sotme letrare shqipe e ka pasqyruar rënjen e ë-së së patheksuar vetëm në rastet kur pas saj vjen një përemër vetor i shkurtër ose pjesëza u e foljeve të formës pësore (*t'i mbyll* etj., *t'u thuash* etj.).

Ndërrime pozicionale

Në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe si të këtillë vërejmë vetëm rënjen e zanores ë të patheksuar në disa pozita të caktuara.

a) ë-ja para theksit të fjalës.

Në këtë pozitë ë-ja e patheksuar nuk shqiptohet kur gjendet në një rrokje të hapët: *emër-emroj* (emëroj), *femër-femrore* (femërore), *i poshtë-roshtroj* (poshtëroj), *i varfër-varfroj* (varfëroj), *gjakës-gjaksi* (gjakësi), *përgjegjës — përgjegjsi* (përgjegjësi), *plotës — plotsoj* (plotësoj), *afër — afroj*, *tepër — teproj*, *kundër — kundrejt*, *pastër — pastroj*, *regjistër — regjistroj* etj. (bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet ku ë-ja ndodhet në rrokjen e parë të fjalës, si: *këput*, *mësoj* etj. dhe rastet, ku me rënjen e ë-së do të krijoheshin këta grupe bashkëtingëlloresh: *rdhr: urdhëroj*, *mbr: shtrembëroj*, *dhr: madhëri*, *rrr: burrëri*, *lr: djalëri*, *llr: gjallëri*, *gjr: agjëroj*, *qr: shoqëri* dhe *shr: kushëri*).

Në drejtshkrimin e sotëm të gjuhës shqipe për shumicën e rasteve nuk është pasqyruar ky këmbim, janë pranuar vetëm ato raste në të cilat ë-ja vjen pas një bashkëtingëllorese të shurdhër (f, k, p, t), pas v-së dhe grupeve të bashkëtingëlloreseve -nd- e -st-: *afroj* (afër), *lakror* (lakër), *teproj* (tepër), *vjetroh* (i vjetër), *lundroj* (lundër), *pastroj* (i pastër) etj.

b) ë — pas theksit të fjalës.

Zanorja ë pas theksit nuk shqiptohet përgjithësisht në rrokje të hapëta që ndodhen brenda fjalës: *emër - emri*, *drapër - drapëri*, *mjeshtër - mjeshtri*, *pjepër, -pjepri*, *lakër - lakra*, *i ashpër - i apshri*, *i egër - i egri*, *pupël - pupla*, *vegël - vegla*, *i ëmbël - i ëmbli*; *ritëm - ritmi*, *marksizëm - marksizmi*, *i sotëm - i sotmi*, *i dukshëm - i dukshmi*, *i etshëm - i etshmi*; *punonjës - punonjsi* (punonjësi), *ndihmës - ndihmsi*, *shitës - shitsi* (shitësi); *dorëz - dorza* (dorëza), *lidhëz - lidhza* (lidhëza), *njerëz - njerzit* (njerëzit), *fjalve* (fjalëve), *rrugve* (rrugëve); *djathra* (djathëra), *ujra* (ujëra), *elbra* (elbëra); *i cekët — i cekti* (i cekëti), *i kthjellët - i kthjellti* (i kethjellëti), *e dobët - të dobtën* (të dobëtën) etj.

Rënjen e ë-së në këtë pozitë drejtshkrimi i sotëm i gjuhës letrare shqipe e ka pasqyruar vetëm në raste ku ajo ndodhet në rrokjen fundore të temave që mbyllen nga një bashkëtingëllore sonante r, l, ose m: *emri* (emër), *i egri* (i egër); *pupla* (pupël), *i vogli* (i vogël); *ritmi* (ritëm), *i sotmi* (i sotëm), *i pjeshmi* (i pjeshëm) etj. Për rastet e tjera drejtshkrimi është mbështetur në kriterin gramatikor dhe etimologjik.

Ndërrimet historike.

Ndërrimet historike pasqyrojnë ligje fonetike që kanë vepruar në faza të mëparshme të historisë së gjuhës e që nuk veprojnë më sot. Ato nuk shpjegohen me normat e sotme fonetike të gjuhës dhe nuk janë të kushtëzuara, ndodhin në kushte të njëjta fonetike, p.sh. **mik** - **miq**, **heq** - **u hoq** etj.

Dikur këto ndërrime janë kryer në kushte fonetike të caktuara; p.sh. në formën e shumësit të emrit **mik** pas **k**-së vinte mbaresa **-i** ose **-i** dhe nën ndikimin e saj **k**-ja u palatalizua, u kthye në **q**; në rastin e dytë (**heq**-**hoqa**) ndërrimi i **e**-së në **o** është bërë për shkak të pozitës në të cilën ndodhej **e**-ja, në këtë rast ajo shqiptohej e gjatë dhe **e**-ja e gjatë u kthye në **o** (shih fonetikën historike të shqipes). Siç shihet, edhe ndërrimet historike janë shkaktuar dikur prej ndikimit të tingujve fqinjë mbi njëri-tjetrin ose prej pozitës që kishte tingulli në një fjalë. Me këto shkaqe fonetike, me këtë rrugë të rregullt të veprimit të ligjeve fonetike që kanë qenë të gjalla në faza të ndryshme të zhvillimit të gjuhës, shpjegohen sot shumica e ndërrimeve historike, por, në gjuhë takojmë edhe ndërrime që janë rezultat i veprimit të ligjit të analogjisë, p.sh.: në gjuhën e sotme letrare shqipe të këtilla janë rastet: **mora**-**muarëm** në vend të **morëm**, **njoh**-**njuh** dhe shumë raste që shihen tek fjalët e huazuara ose tek fjalët të vetë shqipes të hyra e të formuara pasi kish mbaruar së vepruari ligji fonetik që shkaktonte këtë apo atë ndërrim tingujsh. Veç këtyre, në gjuhën e sotme letrare shqipe vërehen edhe ndërrime që nuk shpjegohen as me veprimin e dikurshëm të ligjeve fonetike dhe as me analogjinë, por me faktin se palët që kundërvihen në këtë rast burojnë prej dialekteve (fjalë ose forma dialektore që janë ngritur në normë në gjuhën letrare shqipe): **dashuri**: **dashnor**, **zëri**: **zanore** **rërë-ranishte**, **gruri**-**grunore**; **njoh**-**njoftim**; **asgjë**: **asgjamangut**, **vrejtur**-**vran-sira**; **muaj**: **mujor**, **i mësuar**-**mësues**; **e punuar**-**e punueshme**; **thelbi**-**thel-pinj**, **çarmatim**, ³-**çmallem**; **çnderim**, **çliroj**, **çnjerëzor** (krahaso: **shkul**, **shkarkoj** etj.).

Në gjuhën tonë të shumtën e herës ndërrimet historike takohen në sistemin emëror dhe në sistemin foljor, sidomos në kundërvënjet e formave të njëjësit e të shumësit të emrave dhe në format e ndryshme të kohëve të foljeve.

Ashtu si edhe në gjuhë të tjera, edhe në gjuhën shqipe këto ndërrime janë edhe si mjete gramatikore (të vetme ose të shoqëruara me mjete të tjera plotësuese) për dallimin e formave të ndryshme që marrin fjalët gjatë fleksionit, p.sh. **fik**-**fiq**, **dash**-**desh**, **marr**-**mora**, **njoh**-**njuh**, **kal**-**kuaj**, **flas**-**flet**, **brisk**-**brisqe** etj.

Sot të gjitha ndërrimet historike janë normë edhe për variantin e folur edhe për variantin e shkruar të gjuhës sonë letrare.

a) *Ndërrime bashkëtingëlloresh*

k-q: **mik**-**miq**, **fik**-**fiq**, **armik**-**armiq**, **peshk**-**peshq**, **bujk**-**bujq**: **ujk**-**ujq**, **dushk**-**dushqe**, **brisk**-**brisqe**, **pazarllëk**-**pazarllëqe**, **rrezik**-**rreziqe**, **ndjek** - **u ndoq** - **ndoqa**, **përppjek** - **u përpoq** - **përpoqa**, (ka) **vdekur** - **vdiq**:

3) Rastet me variantin e pareshtesës **sh** nuk paraqesin ndërrime të kushtëzuara fonetiksht, sepse bashkëtingëllorja **sh** qëndron e pandryshuar në po ato kushte ku gjendet **ç**-ja si parashtesë: para zanoreve: **shapka**, para **m**-së: **shmangem**, para **n**-së **shndërroj**, para **i**-së: **shlivë**, **veshël**-**veshla** etj.

g-gj: zog-zogj, murg-murgj, varg-vargje, pellg-pellgje, shëlg-shëlgje, gardh-gjerdhe, i vogël-të vegjël, djeg-u dogj - dogja;

ll-j: kungull-kunguj, shekull-shekuj, mashkull-mashkuj; fyell-fyej, diell-diej, nyell-nej, kërcyell-kërcej, hamall-hamaj ose hamej, mangall-mangaj ose mangej, çakall-çakej, yll-yje, pyll-pyje;

l-j: muskul-muskuj, kal-kuaj, fle-fjeta;

r-j: lepur-lepuj, flamur-flamuj, bir-bij;

s-t: flas-flet, ngas-nget, shkas-shket, shes-shet, (kam pasur-pata);

rr-r: marr-mora, tjerr-tora, nxjerr-nxora, bjerr-bora;

k-s: (kam) vdekur-vdes;

Në ndërrimet s-t, rr-r kemi marrë si primare s-në, rr-në duke u nisur nga gjendja e sotme e gjuhës, kurse historikisht primare janë t-ja dhe r-ja.

b) Ndërrime zanoresh:

a-e: dash-desh, djal-djem, plak-pleq, lak-leq, gardh-gjerdhe, vëlla-vëllezër; natë-net, i ati-t'et, jam-je, marr-merr, dal-del, flas-flet, shkas-shket, thërras-thërret, pashë-pe,

i-j: ndiej-ndjeva ziej-zjeva, bie-të bjerë, shtie-shtjerë! shpie-shpjerë!

e-i: jemi-jini, kemi-kini, merr-mirri, dredh-dridhni — dridhja-dridhet, fsheh-fshihni-fshihja-fshihet, flet-flisni-flisje-flitet, pres-prisni-pri-sja-prietet, vete-vini-vija, vihet, ngre-ngrini-ngrija-ngrihet, fle-flini-flija-flihet;

e-a: thes-thasë, rreth-rradhë;

e-o: heq-hoqa, mbledh-mblodha, hedh-hodha, zgjedh-zgjodha, dredh-drodha, them-thotë;

ë-i: lë-lini-lija-lihet, vë-vini, vija-vihet, zë-zini-zija-

ë-a: lë-lashë, dhënë-dhashë, rënë-rashë, thënë-thashë.

ë-u: vënë-vura, zënë-zura, shpënë-shpura;

o-e: njoh-njeh; shoh-sheh, i vogël-të vegjël;

o-u: mapo-mapua, karro-karrua, depo-depua, Malo-Malua, Spiro-Spirua;

o-ua: dorë-duar, punoj-punuam-kam punuar, fërkoj-fërkuam-kam fërkuar, shkoj-shkuam-kam shkuar, mora-muarëm, dola-dualëm, nxora-nxuarëm;

a-ua: kal-kuaj

a-o: marr-mora, dal-dola;

e-ve: derë-dyer, rrëfej-rrëfyem-kam rrëfyer, kërcj-kërcej-kërcejem-kam kërcyer;

ua-o: ftua-ftoi-ftonj, krua-kroi, kronj, thua-thoi-thonj, krahëruar-krahërori, lakruar-lakrori, shkruaj-shkrova, bluaj-bluve, kruaj-krova, paguaj-pagova;

ua-a: grua-gra;

ua-u: shkruaj-shkruhet, bluaj-bluhet, paguaj-paguhet, kruaj-kruhet;

ye-e: nye-neni, kërcyell-kërçelli, krye-krerë, kryej-kreva, lyej-leva, ngjyey-ngjyeva, shqyey-shqyeva;

ye-y: lyej-lyhet, fyej-fyhet, zhgryej-zhgryhet, përlyej-përlyhet;

ie-i: ziej-zihet, shpie-shpihet-shpija, ndiej-ndihet, përziej-përzieh;

je-o: mbjell-mbolla, ndjell-ndolla, pjell-polla, pjek-poqa;

je-i: mbjell-mbillja-mbillet, pjell-pillja-pillet, nxjerr-nxirrja-nxirret, pjek-piqja-piqet, vjet-vit.

Në ndërrimet e zanoreve *e-a*, *ë-a*, *ë-e*, *ua-o* dhe *ye-e* historikisht primare janë zanoret e krahut të dytë, dmth, *a*-ja ka dhënë e tek thes-thasë, rreth-rrathë, ka dhënë ë tek lë-lashë etj., *e*-ja ka dhënë ë tek krëhër-kreh, *o*-ja ka dhënë ua tek shkruaj-shkrova dhe *e*-ja ka dhënë ye tek nye-neni, lyej-leva etj.

Përveç këtyre, në gjuhën e sotme shqipe ka edhe një tip tjetër ndërrimesh historike që afrohen nga ana e jashtme me ndërrimet mekanike. Të këtilla ndërrime nuk shpjegohen me normat e sotme fonetike të gjuhës, ashtu sikurse edhe ndërrimet e tjera historike të përmendura, por në të njëjtën kohë vërehet se ato ndodhin në kushte të caktuara fonetike, pra ashtu si ndërrimet mekanike, p.sh. shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës: *elp-elbi*, *i madh-i madhi*, *ndes-ndeze* etj., rënja e *e*-së në raste si këto: *dele-delja*, *lule-lulja* etj.

Këto lloj ndërrimesh vërtet vërehen në kushte të caktuara fonetike, por jo në të gjitha rastet pa përjashtim; një proces i këtillë është kufizuar në një numër rastesh, sepse në po ato kushte fonetike vërehet edhe e kundërta, p.sh. krahas *elp-elbi* etj. gjejmë *pedagog-pedagogu*, *trapez-trapezi*, *plazh-plazhi* etj., ose krahas *lule-lulja* gjejmë edhe (një) *lule-(një) luleje* etj.

Fakti që ky proces nuk i përfshin të gjitha rastet do të thotë se këto ndërrime nuk ndodhin nga veprimi i ligjeve të sotme fonetike të gjuhës. Duke qenë kështu, themi se kushtëzimi i tyre fonetik që vërehet sot është një tipar i jashtëm, jo qenësor, prandaj ndërrime të këtilla radhiten në këmbimet historike e jo në ndërrimet mekanike.

Ndërsa ndërrimet e tjera historike i kanë humbur sot krejtësisht gjurmët e kushtëzimit të dikurshëm fonetik, këto i ruajnë ende. Rregullsitë që kanë ekzistuar dikur edhe për ndërrime të këtilla janë prishur gjatë historisë së gjuhës sonë në shumicën e tyre për shkak të faktorëve fonetikë e në disa raste edhe për shkak të faktorëve gramatikorë.

Këto ndërrime në gjuhën e sotme shqipe letrare janë vetëm pozicionale.

Bashkëtingëlloret e zhurmëta të zëshme kthehen në bashkëtingëllore të zhurmëta të shurdhëta kur ndodhen në fund të fjalës: **g-k**: *zok (zog) zogu*, *lënk (lëng) - lëngu*, *djek (djeg) - djegim*; **lak (lag) - lagim**; **gj-q +**: *qenq (qengj)-qengji*, *u derq (u dergj) - dergjem*, *u doq (u dogj) - digjem*, *u përgjiq (u përgjigj) - përgjigjem*; **xh-ç**: *xhuç (xhuxh) -xhuxhi*, *tunç (tunxh) - tunxhi*, **z-s**: *mës (mëz) - mëzi*, *bres (bres)-brezi*, *u ndes (u ndez) - ndezi*; **d-t**: *vent (vend) - vendi*, *kënt(kënd) - këndi*, *u përment (u përmend) - përmendi*; **dh-th**: *leth (ledh) - ledhi*, *i madh(i madh) - i madhi*, **v-f**: *urof (urov) - urovi*; **b-p**: *elp (elb) - elbi*, *qelp (qelb) - qelbi*, *dhëmb (dhëmb) - dhëmbi*, *u kalp (u kalb) - kalbi*, *i dhemp (i dhemb) - i dhembin* etj.

Ky fenomen nuk është pasqyruar në ortografinë e sotme, sepse ka një bazë dialektore të ngushtë. E trajtuam në këtë artikull, mbasi në fazën e sotme të gjuhës letrare shqipe në variantin e folor ka një përdorim të madh. Shurdhimi e mosshurdhimi sot përbëjnë norma variante për gjuhën letrare. Ka mundësi që më vonë të dalë jashtë normës letrare shqiptimi me shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës.

Në një numër të vogël rastesh sot në gjuhën letrare shqipe vërehet edhe ndërrimi i zanoreve *a* dhe *e* të theksuara me *ë*-në e patheksuar kur kalojnë nga një rrokje e theksuar në një rrokje të patheksuar: **a-ë**: *shparg-shpërngënj*, *plaf-plëfënj*, *i madh-të mëdhenj*, *i bardhë (ë) -i zbërdhuqur*, *palla-pëllas*, *plasa-pëlcas*; **e-ë**: *cen-cënoj shenj(ë)-shënoj*, *i keq-të këqinj*;

i-ë: *thirra-thërras, brita-bërtas*; **o** - zero: *fola-flas*. Në fazën e sotme të gjuhës letrare shqipe kjo dukuri është shumë e kufizuar në raste, kurse në dialekte atë e gjejmë më dendur.

Në një numër rastesh vërehet se bie zanorja *e* e patheksuar që ndodhet në rrokjen e parafundit fill pas theksit të fjalës, p.sh.: *artiste-artistja, bebe-bebja, dele-delja, bashkëtingëllore-bashkëtingëllorja, fshat-tare-fshatarja, gjethe-gjethja, hile-hilja, lule-lulja, mace-macja, shishe, shishja; teze-tezja, vitore-vitorja, zijoshe-zijoshja; e kuqe - e kuqja, e sjellshme-e sjellshmja, e vetme-e vetmja* etj. Me këto shkojnë edhe rastet e emrave të veprimit dhe disa emra të tjerë me prapashtesën *je*: *ardhje-ardhja, dalje-dalja, çarje-çarja, falje-falja, larje-larja, prerje-prerja, tharje-tharja, vënje-vënja* etj., *kembje-këmbja, gishtje-gishtja, elbje-elbja*.

R é s u m é

L'ALTERNATION DE TIMBRE DANS L'ALBANAIS LITTÉRAIRE

Dans cet article sont traitées ces alternations phonétiques qui représentent la norme de la langue littéraire contemporaine albanaise. Pour ce qui est du rythme du parler, sont considérées ces alternations qui sont caractéristiques seulement au style complet et non point celles du style conversationnel rapide.

Les critères sur lesquels s'est basé l'auteur pour l'analyse de cette question se trouvent en détail dans un autre article, intitulé: *A propos du traitement des alternations phonétiques dans la «Grammaire de l'albanais contemporain»*, paru dans les «*Studime filologjike*» 3, 1969, 207-211.

Sur la base du critérium phonétique, c'est-à-dire sur le fait dans quelle mesure sont conditionnées phonétiquement les alternations des timbres, elles sont divisées en *alternations mécaniques*, c'est-à-dire en phénomènes expliqués par les lois phonétiques qui agissent actuellement en albanais et en *alternations historiques* (traditionnelles), c'est-à-dire en alternations qui reflètent les lois phonétiques qui ont été agissantes dans des phases du développement de l'albanais, et qui actuellement ne le sont plus.

Exemples typiques des *alternations mécaniques*:

1. *alternations combinatoires*: *azgjë (asgjë), z'gjej (s'gjej), togzoi (tokëzoi), trathiti (tradhëti), diqte (digjte); ja dha (cfr. i dha), hapja derën / (cfr. hapi derën), luftoi (luftoi), të zotë (të zottë), mate (matte), pasi (pas+si), faqa (faqja), paqa (paqja), uis (ujis), vai (vaji) t'egra (të egra) m'i dha (më i dha)*;

2. *alternations positionales*: *emër-emroj, afër-afroj; drapër-drapri, pupël-pupla, shitës-shitsi, njerëz-njerzit; i egri (i egër), ritmi (ritëm), e pjeshme (e pjesëshme)*, etc.

Exemples des *alternations historiques*:

1. *alternations de consonnes*: *mik-miq, ndjek-ndoqa, kungull-kunguj; muskul-muskuj, bir-bij, lepur-lepuj, flas-flet, marr-mora*;

2. *alternations de voyelles*: *dash-desh, shkas-shket, kemi-kini, vete-vini, thesthasë, heq-hoqa, zë-zini, vënë-vura, lë-lashë, njoh-njeh, marr-mora, kal-kua, dorë-duar, ftua-ftoi, grua-gra, lyej-leva, fytej-fyhet, mbjell--mbillje, vjet-vit*, etc.

En outre, l'auteur Gjinari croit qu'en albanais contemporain il existe un autre type aussi d'alternations historiques qui se rapprochent du côté extérieur avec les alternations mécaniques. De telles alternations ne sont pas expliquées avec les normes phonétiques actuelles de la langue, au même titre que les autres alternations historiques, mais on observe dans le même temps qu'elles ont lieu dans des conditions phonétiques données, au même titre que les alternations mécaniques, p.ex. l'assourdissement des consonnes sonores à la fin du mot: *elp-elbi*, *i math-i madhi*, *ndes-ndeza*, ou bien chute de l'*e*, dans des cas tels que: *dele-delja*, *lule-lulja*, car aujourd'hui on a aussi *pedagog-pedagogu*, *trapez-trapezi*, *lule-një luleje*, etc. Au contraire, les autres alternations historique ont perdu actuellement complètement les traces du conditionnement phonétique de jadis, celles du type *i math-i madhi*, *dele-delja*, etc., conservent encore les conditions phonétiques dans lesquelles elles ont lieu, mais que la loi phonétique a déjà cessé d'agir.

